

## **D E K R E T**

**Nr. 782, date 22.02.1994**

### **PER SISTEMIN FISKAL NE SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KERKIM - PRODHIMI)**

Ne mbeshtetje te nenit 28, pika 19, te ligjit Nr. 7491, date 29.04.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave

#### **D e k r e t o j,**

##### **Neni 1**

Kontraktuesi detyrohet te paguaje cdo vit fiskal vetem tatimin mbi fitimin e realizuar ne ate vit fiskal. Fitimi i realizuar mund te shprehet ne natyre a ne para ose ne forme te perziere, sic mund te parashikohet ne cdo marreveshje hidrokarburesh.

Tatimi mbi fitimin eshte :

1. Ne masen 50 per qind te fitimit te realizuar.
2. Ne rast se kontraktuesi, ne perputhje me nenin 12, pika 2, te ligjit "Per hidrokarburet" eshte Albpetroli dhe ky zoteron nga 50 per qind deri ne 100 per qind te interesave ne marreveshje hidrokarburesh, tatimi eshte :
  - a) 30 perqind te fitimit te realizuar nga objektet e zbuluara dhe te vena ne shfrytezim perpara dates 31.12.1993
  - b) Per fitimin e realizuar nga zona te tjera (te vena ne shfrytezim pas dates 31.12.1993) tatimi mbi fitimin eshte :
    - 30 per qind per sasi hidrokarburesh te prodhuara deri ne 20.000 barela ne dite.
    - 50 per qind per cdo sasi hidrokarburesh shtese te prodhuara nga 20.000 deri ne 50.000 barela ne dite
    - 55 per qind per cdo sasi hidrokarburesh shtese te prodhuara nga 50.000 deri ne 65.000 barela ne dite
    - 60 per qind per cdo sasi hidrokarburesh shtese te prodhuara mbi 65.000 barela ne dite
3. Per shfrytezimin e vendburimeve marginale te zbuluara ose te kthyer ne marginale nga shfrytezimi i tyre, Keshilli i Ministrave mund te nxjerre vendime te posacme per lehtesimin e sistemit fiskal me qellimin e vetem qe keto lloj vendburimesh te kthehen ne ekonomikisht te shfrytezueshme.

## **Neni 2**

Per efekt te llogaritjes se fitimit te realizuar, kontraktuesit i njihen si kosto shpenzimet kapitale, ato operative e administrative etj. (specifikimet perkatese behen ne cdo marreveshje hidrokarburesh e miratohen nga ministri) dhe lejohet shlyerja e tyre nga te ardhurat e fituara sipas kriterëve te pranuar nga ministri, si dhe sipas praktikave nderkombetare te industrise se naftes qe zbatohen ne cdo marreveshje hidrokarburesh.

## **Neni 3**

Kontraktuesi dhe nenkontraktuesit e tij perjashtohen nga detyrimet doganore per paisjet, makinerite, materialet, etj.

Gjithashtu, trajtohen njelloj si ne paragrafin e mesiperem te ketij neni edhe mjetet e jeteses se punonjesve te huaj te kontraktuesit e nenkontraktuesve te tij, qe lidhen me operacionet e naftes, ne rast se nuk vendoset ndryshe nga Keshilli i Ministrave.

## **Neni 4**

Punonjesit e huaj te kontraktuesit dhe nenkontraktuesve te tij perjashtohen nga tatimi mbi te ardhurat personale qe sigurohen nga operacionet e naftes.

## **Neni 5**

Ky dekret hyn ne fuqi menjehere.

**KUNDERFIRMOHET**

**KRYEMINISTRI**

**Aleksander MEKSI**

**PRESIDENTI I REPUBLIKES**

**Sali BERISHA**